

SI TË
ÇLIROHEMI
PREJ
HIDHËRIMIT



Titulli: Si të çlirohemi prej hidhërimit
Origjinali: How to be free from bitterness
Autori: Grup Autorësh
Përkthyen: Alfred Kola, Holger Dashi
Redaktuan: Pandush Ikonomi, Dan Baynes



Boton:
AEM-MISIONI UNGJILLOR

Rr. e Barrikadave, Nr. 125, Tiranë

web: www.aemission.al

email: libraria@aemission.al

Tiranë, 2025

ISBN version elektronik: 9789992795996

SI TË ÇLIROHEMI PREJ HIDHËRIMIT

Përmbajta:

1.	Sitëçlirohemi prej hidhërimit.....	4
2.	Inati i njeriut	23
3.	Inatosja ndaj fyerjes	27
4.	Fre gjuhës	30
5.	Analiza e vetvetes	33

1. Si të çlirohemi prej hidhërimit

nga Jim Wilson

"Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi. Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njëri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin. Bëhuni pra imitues të Perëndisë, si bij shumë të dashur, edhe ecni në dashuri, sikurse edhe Krishti na deshi dhe e dha veten e Tij për ne, si ofertë e flijim Perëndisë, si një parfum erëmirë"

Efes. 4:31-5:2

Në këto vargje na mësohet të heqim qafe çdo lloj hidhërimi. Para se të fillojmë të diskutojmë si dhe pse duhet bërë kjo, është e domosdoshme të kuptojmë se baza për të gjitha veprimet tona për sa i përket këtij qëllimi duhet të jetë ato që bëri Jezu Krishti për ne në kryq. Në të gjitha veprimet tona të jemi imitues të Përendisë.

Në Dhiatën e Vjetër kishte një grua emri i së cilës kishte kuptimin E Këndshme. Ajo quhej Naomi dhe ishte shpërngulur nga Izraeli në një vend tjetër bashkë me burrin dhe dy djemtë. Por burri i vdiq dhe brenda dhjetë vjetësh pastaj i vdiqën edhe të dy djemtë. Për këtë ajo u tha nuseve sapo të bëra vejusha: "Kushtet në të cilat ndodhem janë më të hidhura nga tuajat, sepse dora e Zotit është shtrirë kundër meje" (Ruthi 1:13). Ajo po bënte krahasimin me qëllim që të përcaktonte kush kishte të drejtë të ishte më e hidhëruar.

Ajo tha: "Mos më quani Naomi: thirr mëni Mara, sepse i Plotfuqishmi më ka mbushur me hidhërim. Unë u nisa në bollëk dhe Zoti më ktheu në shtëpi të zhveshur nga çdo gjë. Pse të më quani Naomi, kur Zoti ka dëshmuar kundër meje dhe i Plotfuqishmi më ka bërë fatkeqe" (Ruthi 1:20-21).

Hidhërimi i saj ishte kundër Perëndisë. Ishte Perëndia Ai që ia kishte marrë burrin. Ishte Perëndia Ai që ia kishte marrë dy djemtë, dhe këtë e mbajti kundër Tij. Pesë herë në këto tri vargje ajo e bën përgjegjës Perëndinë për hidhërimin e saj.

Sot ka shumë njerëz të këtillë. Ata jo vetëm që janë të hidhëruar, por u gëzuakan të atillë. Sikur atyre u pëlqen, dhe ushqehen me të. Nuk do të dinin se ç'mund të bënin sikur të hiqnin hidhërimin, pa të nuk do të kishin qëllim në jetë. U pëlqeka të jenë të hidhëruar.

Ne njohim njerëz të tillë në botë dhe njohim të tillë edhe nëpër kisha. Është mjaft e lehtë të dallosh kur dikush është i hidhëruar. Mund ta shohësh atë në sytë dhe pamjen e fytyrës, madje edhe sikur personi të jetë mjaft i ri në moshë. Mund ta shohësh atë në gojë, kur buzëqesh apo kur qesh. Ata janë të hidhëruar e mund ta dallosh këtë. Mund ta dëgjosh atë në tonin e zërit të tyre. Mund ta dëgjosh kur protestojnë se nuk janë të hidhëruar. Hidhërimi është në thelb dhe mbizotëron mbi çdo gjë.

Në Bibël ka edhe njerëz të tjerë të hidhëruar përveç Naomit. Në fakt ka shumë. Për shembull, Jona ishte njeri i hidhëruar. Zoti i tha: "A të duket e drejtë të zemërohesh kështu për bimën?"

— Po, është e drejtë për mua të zemërohem deri në vdekje, - ai u përgjigj (Jona 4:9).

Ai mendonte se kishte të drejtë për t'u inatosur. Sikur të thoshte: "Më pëlqen të jem i inatosur. O Perëndi, e ke gabim që i fal njerëzit. Nuk dua që të falësh njerëzit".

Njerëzit kënaqen t'i mbajnë meritë kundër të tjerëve. Kurse vargjet që cituam më sipër nga Letra drejtuar efesianëve kërkojnë që ne të largojmë gjithë hidhërimin dhe të mbajmë një zemër të butë. Qëndron problemi: "A është e mundur të jesh i mirë, i dhembshur dhe zemërbutë dhe në të njëjtën kohë i liidhëruar?" Këto janë të gjitha qëndrime të brendshme. Zemërbutësia, sipas vetë kuptimit të fjalës, do të thotë të kesh një zemër të butë. Hidhërimi është gjithashtu i brendshëm. Por nuk është e mundur të kesh në brendësi dy qëndrime të ndryshme dhe kontradiktore.

Pali thotë se duhet të heqim qafe hidhërimin dhe të jemi të mirë e të dhembshur me njëri-tjetrin. Prandaj, hidhërimi duhet të largohet. Por përpara se të hiqet qafe, është e nevojshme të dimë çfarë është dhe se është i pranishëm.

Është relativisht e lehtë ta kuptojmë kur njerëzit e tjerë janë të hidhëruar. Por, nuk është aq e lehtë ta shohim atë brenda vetes. Prandaj është e rëndësishme të dimë mirë përkufizimin biblik të këtij problemi.

Le të supozojmë se një besimtar kryen një mëkat. Për shembull, ai thotë një gënjeshtëri. Po kur ai thotë gënjeshtëtrën, a ndihet fajtor apo i hidhëruar? Përgjigjja është, fajtor. Kur mëkatojmë ndihemi fajtorë. Kjo është e qartë. Tani le të supozojmë se dikush thotë një gënjeshtëri për këtë besimtar dhe e përhap atë në gjithë qytetin. Çfarë ndien tani besimtari - fajësi apo hidhërim?

Ne ndiejmë fajësi kur mëkatojmë vetë, kurse *ai që e ndiejmë kur mëkatojmë të tjerët kundër nesh është hidhërimi*. Vetë përkufizimi i hidhërimit tregon vep-

rimin e një tjetri. Në qoftë se kishim mëkatuar, do të ndiheshim fajtorë dhe do të dinim se duhet ta rrëfenim dhe braktisnim mëkatin tonë.

Mund të ndodhte që të mos e rrëfenim mëkatin, por jo sepse nuk dinim ç'duhet bërë. Por çfarë bëjmë me fajin e të tjerëve? Hidhërimi bazohet gjithmonë në mëkatin e dikujt tjetër, qoftë ky mëkat real apo imagjinar.

Të shqyrtojmë së pari mëkatin imagjinar. Shumë herë mund të hidhërohemi me ndonjë për atë që "ka thënë", kur në fakt nuk e ka thënë. Kemi dëgjuar llafe të rreme dhe tani jemi në hidhërim. Presim që personi të kërkojë ndjesë, por ai s'mundet. A do të mbetemi në hidhërim për gjithë jetën sepse ai nuk thotë kurrë "më vjen keq" për diçka që kurrë s'e ka bërë?

(Meqë ra fjala, shumë njerëzve të hidhëruar nuk u shkon në mendje se mund të jenë të hidhëruar prej mëkatesh imagjinare. Përsa i përket hidhërimit, është gjithmonë real faji i personit tjetër. Zakonisht mendojmë se është gjë e palejueshme që t'i hedhim faj një njeriu të pafajshëm thjesht për interesat tona. Por, për një person që përpiqet të çlirohet prej hidhërimit, është e pranueshme për të që të mendojë se faji i personit tjetër është vërtet real edhe në qoftë se nuk është, vetëm që duhet të heqë qafe hidhërimin e vet.)

Po të kryhet ndonjë mëkat i vërtetë, ç'mund të themi për atë? Ka shumë njerëz të hidhëruar të cilët me të vërtetë janë keqtrajtuar prej ndonjë njeriu tjetër. Kështu pra, ç'duhet të bëjmë me një mëkat të vërtetë?

Hidhërimi bazohet në mëkatin që lidhet në një farë mënyre me ty. Ai nuk ka të bëjë me madhësinë e mëkatit, por bazohet në atë se sa pranë e ke. Për shembull, në qoftë se në Iran, Irak, El Salvador, apo Kolumbi ndodh një imoralitet i madh e i rëndë, çfarë bëjmë? Ne lexojmë për këtë, por nuk ndihemi fajtorë. Lexojmë por nuk ndihemi të hidhëruar. Mund të neveritemi dhe të çuditemi, por nuk ndihemi as fajtorë as të hidhëruar, megjithëse është mëkat i tmerrshëm dhe dikush e kreu faktikisht. Pra, hidhërimi nuk varet nga madhësia e mëkatit, por nga afërsia që ka tjetri me ty. Hidhërimi lidhet me njerëzit që i ke pranë.

Cilët janë kandidatët me të ngjarë për hidhërim? Përgjigjja është e thjeshtë: baballarët, nënat, vëllezërit, motrat, burrat, gratë, fëmijët, shokët, shoqet, shokët e dhomës, eprorët dhe vartësit e drejtpërdrejtë, bashkëpunëtorët, ortakët, ndoshta dhe disa të tjerë nga farefisi si gjyshërit, gjyshet, xhaxhallarët e të tjerë. Ka bile shumë njerëz të cilët janë të hidhëruar me Perëndinë.

Ne nuk ndiejmë hidhërim për të këqijat që s'kanë të bëjnë me ne. Hidhërimi bazohet në mëkatin e dikujt tjetër i cili është i afërt me ne dhe ka bërë diçka kundër nesh. Të jetë një gjë e vogël. Nuk duhet të jetë gjë e madhe, por

vetëm të jetëgjë e afërt. A i la çorapet në dysHEME? Po? A mund të hidhërohesh për këtë? Jo, por ç'do të thuash sikur ai ta bëjë këtë 5.000 herë?

Ti mund të mendosh se ke të drejtë të hidhërohesh. Por Bibla nuk i jep askujt të drejtën të hidhërohet. Vargjet e cituara na thonë që të heqim qafe gjithë hidhërimin.

"...duke u kujdesur fort që askush të mos mbetet pa hirin e Perëndisë dhe se mos mbijë ndonjë rrënjë e hidhur dhe t'ju turbullojë dhe me anë të saj të ndoten shumë njerëz"

Heb.12:15

Këtu na përshkruhet hidhërimi sikur të ishte një rrënjë. Rrënja është diçka që është e nëndheshme, dhe kështu që nuk duket. Por mund të kuptojmë se ka një rrënjë p.sh. kur shkallmohen trotuarët.

Rrënjët bëjnë gjëra të tjera. Fakti që nuk i sheh rrënjët nuk do të thotë se ato nuk ekzistojnë dhe se nuk do t'i shohësh ndonjëherë. Ato thithin ushqim dhe nuk mbeten rrënjë por me kalimin e kohës mbijnë.

Fruta që lind ka lidhje të drejtpërdrejtë me rrënjën që e prodhon. Rrënjët e një peme molle na japin mollë. Në qoftë se është rrënjë e hidhur do të prodhojë fruta të hidhura.

Këtë e thotë ky varg. Kujdesuni që të mos mbijë rrënjë hidhërimi, dhe të shkaktojë turbullim, dhe të ndyjë shumë veta, që do të thotë të ndotë njerëzit. A ke parë ndonjëherë që hidhërimi të përshkojë ndonjë bashkësi besimtarësh? Hidhërimi mund të përhapet nëpër bashkësi ashtu sikundër zjarri në pyllin e dendur me pisha. Ai mund të përshkojë vendin e punës ose konviktin. Pse ndodh kjo? Dikush vendosi ta ndajë. Ai ishte i hidhëruar, e la rrënjën të dalë dhe të lëshojë fruta. Ai e ndau dhe u hidhëruan shumë të tjerë. Për këtë na paralajmëron autori i Hebrenjve. Ai thotë të hapësh sytë që të mos mbetesh pa hirin e Perëndisë. Kur lejon të ndodhë kjo, del hidhërimi dhe ndot shumë veta. Fëlliqen shumë njerëz.

Çfarë ndodh me një person në qoftë se mban përbrenda hidhërimin për shumë vite? Çfarë ndodh fizikisht me të? Mund të sëmuret ai fizikisht? Të supozojmë se është hidhërim ndaj ndonjërit prej anëtarëve të familjes. E ka mbajtur atë përbrenda dhe nuk e ka ndarë. Ai nuk ka ndyrë shumë njerëz, sepse e ka mbajtur thellë përbrenda. Kur vepron kështu, mbas disa vitesh ai fillon më së fundi të dëmtohet. Shkon tek doktori dhe ai i thotë: "Keni të drejtë që jeni sëmurë. Mirëpo sëmundja juaj nuk është prej atyre që kuroj unë. Do t'ju dërgoj tek lloji tjetër doktori".

Kështu ai e dërgon tek psikiatri dlre psikiatri bie dakord. "Po, sigurisht që jeni sëmurë. Dhe unë e di përse jeni sëmurë. Jeni sëmurë për shkak

të 20 vjetëve hidhërimi me babanë tuaj. E keni mbajtur atë të ndrydhur për gjithë këto vite, dhe kjo ka bërë që brendësia juaj të jetë kalbëzuar e prishur. Ju e keni mbajtur brenda këtë helm dhe ky acid përbrenda jush ju ka sëmurrur fizikisht. Pra ajo që unë dëshiroj të bëni është të shkoni në shtëpi e ta ndani këtë me babanë tuaj. Pse e mbani brenda dhe sëmureni? Lëshojeni! Sëmurni të tjerët!"

Kështu bota ka dy zgjidhje. Mbaj përbrenda hidhërimin, dhe sëmuri veten, ose lëshoj jashtë dhe shpërndaje rreth e rrotull sëmurdjen. Kurse zgjidhja e Perëndisë është ta shkulësh rrënjën. Hiqe qafe atë. Veçse kjo kërkon hirin e Perëndisë. Njeriu duhet të njohë Zotin Jezu Krisht që të ketë mundësi të bëjë këtë gjë. Ai është burimi i hirit.

Rrugëzgjidhjet që ofron bota nuk duhen përdorur nga besimtarët. Kur besimtarët imitojnë botën, kanë këto dy rrugëdalje të mjera. Bibla thotë që të heqim qafe gjithë hidhërimin. Nuk duhet ta mbash atë përbrenda dhe as ta ndash atë me të tjerët. Dorëzoja atë Atit nëpërmjet Birit.

"Por në qoftë se në zemrën tuaj keni smirë të hidhur dhe grindje, mos u mbani me tëmadh dhe mos gënjeni kundër sëvërtetës. Kjo nuk është dëituri që zbret nga lart, por është tokësore, shtazore, djallëzore. Sepse atje ku ka smirë dhe grindje, atje ka trazirë dhe gjithfarë veprash të këqija"

Jakobi 3:14-16

Kur isha i ri, si nënoficer në Akademinë Detare, e besoja se kur njerëzit rriten, ata piquen dhe kështu zhduket gjithë xhelozia dhe të qenët zemërn-gushtë. Mendoja se sa më lart të ngjitesh në rang aq më i pjekur bëhesh dhe aq më pak do të ndodhin gjëra të tilla. Por ndërsa rritesha zbulova se xhelozia bëhej më intensive. Hidhërimi akumulohet. Në mos ketë një zgjidhje për këtë gjë, njerëzit nuk bëhen më pak të hidhëruar kur piquen, por gjithmonë e më shumë me kalimin e viteve. Pra ai bëhet keq e më keq.

Dhe në qoftë se mban përbrenda smirë të hidhëruar, atëherë do të rezultojnë vepra të këqija. Kjo gjë nuk vjen prej qiellit. Ajo vjen drejtpërsëdrejti prej djallit. Çdo vepër e keqe rezulton prej këtij qëndrimi. Pra, siç duhet të shihet, kemi një problem të madh. Si mund të heqim qafe hidhërimin?

Përpara se ta heqim qafe, na duhet të kuptojmë se jemi të hidhëruar. Por si mund të dallojmë nëse jemi të hidhëruar?

Në radhë të parë duhet të mbajmë mend se **hidhërimi kujton detaje**. Ti ke pasur mijëra bashkëbisedime në jetën tënde, shumicën e të cilave e ke harruar. Kurse ky ka ndodhur 5 vjet më parë dhe ti kujton çdo fjalë, intonacionin e bashkëbiseduesit si dhe lëkundjet e çdo pjese të zërit. Ti e di saktësisht ç'ka ndodhur - pra kjo do të thotë se je i hidhëruar.

Dikush mund të kundërshtojë dhe të thotë se është plotësisht e mundur që të kesh një kujtesë mjaft të mirë edhe për një bashkëbisedim të mrekullueshëm. A është e mundur kjo? Po, por s'ka të ngjarë. Pse jo? Sepse kujtesa ndihmohet nga **shqyrtimi dhe rishqyrtimi i çështjes**. Njerëzit nuk mendohen shumë për gjërat e mrekullueshme. Kurse gjërat e këqija i rishqyrtojnë shumë herë. Unë kam bërë mjaft këshillime me njerëz të cilët ishin në procesin e divorcimit. Disa prej tyre i kam njohur që në dasmën, pra në kohën kur jeta e tyre ishte e lumtur. Kurse në kohën e divorcimit, ata nuk mund të kujtojnë asnjë moment të lumtur. Ato që mund t'i kujtojnë janë vetëm ato që i kanë shqyrtuar e rishqyrtuar shumë herë. Janë të hidhëruar.

Kjo nuk do të thotë se s'kanë kaluar kohëra të lumtura, por nënkupton vetëm se janë përqendruar tek ajo se sa të drejtë kishin dhe sa të gabuar ishte tjetri. Në qoftë se dikush ka një kujtesë të mprehtë e të hollësishme për gjërat që kanë ndodhur vite më parë, kur ka qenë fëmijë, djalosh apo vajzë e re dhe kujtesa e akuzon sadopak dikë tjetër, atëherë kjo është një shenjë hidhërimi. Dhe zgjidhja për hidhërimin është ta heqësh qafe.

Unë pata një përvojë të mrekullueshme njëherë në Dallas të Teksasit. Po flisja një të shtunë mbrëma në shtëpinë e një miku tim të vjetër dhe me qenë se do të qëndroja në Dallas, u shkrova disa njerëzve nga vende të ndryshme të shtetit me të cilët isha i njohur në kohëra të tjera, dhe ata erdhën në këtë shtëpi.

I zoti i shtëpisë më kërkoi të flisja për hidhërimin dhe kështu bëra. Më pas erdhi të më takonte edhe një çift. I kisha njohur 8 vjet më parë në Pullman, Uashington. Gruaja m'u afrua dhe më tha: "Kemi 8 vjet të martuar. Vitin e parë të martesës isha aq shumë e hidhëruar me mamanë time sa që çdo ditë tim burri ia ngarkova. Viti i parë i martesës ishte i tmerrshëm, sepse unë vazhdoja ta ndaja me burrin këtë hidhërim kundër nënës sime".

Pastaj më tha se shtatë vjet më parë unë kisha folur për hidhërimin dhe të sajën e kishte hequr qafe. Një ditë pa një grua tjetër e cila ishte hidhëruar shumë me mamanë e saj. Mendoj se mund ta ndihmonte këtë grua duke ia treguar të gjitha përvojat e përbashkëta. Kështu shkoi që t'ia ndante këto, por nuk mund të kujtonte asnjë prej detajeve, sepse kujtesës i kishin ikur detajet. E gjitha që mund t'i thoshte ishte se e kishte zakon t'i kujtonte gjërat, kurse tani nuk mund t'i kujtonte më. Zoti e kishte çliruar me të vërtetë prej hidhërimit të saj.

Një herë tjetër po jepja mësim për martesën në një kurs katërvjesh. Kisha bërë një lajmërim në gazetë dhe nuk e dija se kush do të vinte. Erdhi një grua e cila i ishte referuar kursit nga një cioktor. Ajo hyri brenda dhe unë po them me gjithë mend se nuk kam parë kurrë në jetën time asnjëri me

pamje më të hidhëruar. Ajo kishte 40 vjet që grumbullonte hidhërim. Atë natë ajo e hoqi qafe krejt hidhërimin dhe më la një takim ditën tjetër në librarinë ku unë punoja. Kur hyri në dyqan, unë nuk e njoha se kush ishte. Ajo dukej krejt ndryshe. Megjithëse e kisha takuar një natë më parë, *ajo tani ishte krejt ndryshe sepse ishte e pastër përhenda*.

Pra, ku qëndron problemi? Pse nuk e heqim qafe hidhërimin? Në qoftë se them një gënjeshtër, mund ta rrëfej atë, dhe të falem. Me qëllim që ta heq qafe më duhet t'ia kthej zemrës sime. Ajo që duhet të bëjmë është që t'ia kthejmë zemrës sonë njohjen e hidhërimit. Kurse tundohemi ta shikojmë ofenduesin. "Shiko çfarë bëri ai". Kjo është natyra e hidhërimit. Me qëllim që ta heq qafe atë, para se ta pohoj dhe ta braktis duhet të kuptoj se ky është problemi **im**.

Ti mund të thuash se nuk je i hidhëruar, se prekesh lehtë. Por simptomat e lëndimit janë shumë afër me ato të zemërimit. A e di ç'është zemërimi i menjëhershëm?

Mund të thuash se nuk është hidhërim, është thjesht lëndim ndjenjash. Por, ka një marrëdhënie të ngushtë midis të qenit i lënduar dhe të qenit i zemëruar. Dikush lëndohet dhe pastaj zemërohet. Ka edhe një lidhje tjetër shumë të ngushtë midis zemërimit dhe hidhërimit. Zemërimi kthehet në hidhërim të thellë. Hidhërimi është pikërisht zemërimi që është mbajtur me rrokje. Ai është qelbur dhe kalbur. Ai po mbahet përbrenda dhe po keqësohet.

Dhe vazhdojnë hallkat në zinxhir. Ka një lidhje midis hidhërimit dhe urrejtjes si dlre një identifikim biblik shumë të qartë midis urrejtjes dhe vrasjes. Po ju them pikërisht se lëndimi mund të çojë drejt vrasjes. Dikush mund të bëjë kundërshtimin se ky mësim është tepër i fortë. Por fuqia e këtij mësimi vjen prej Biblës.

Ajo që duam të bëjmë, është ta bëjmë të qartë q'mëkat i madh është hidhërimi. I hidhëruari duhet të njohë së pari se është i tillë dhe së dyti se kjo është një e keqe vigane. Përsëri, arsyeja që njerëzit nuk e heqin qafe këtë mëkat është se mendojnë që ky është mëkat i tjetrit. Djalli thotë: "Dëgjo! Kur ai që gënjen kundër teje të ndalë së gënjeri, ose të mos bëjë më atë-këtë, ose kur të të thotë më fal, atëherë do të ndihesh më mirë".

Po sikur personi tjetër të mos e ndalë? A do të qëndrosh i hidhëruar gjithë jetën sepse dikush tjetër këmbëngul të mbetet në mëkat? S'ka aspak kuptim. Në qoftë se thua: "Do ta fal kur të më thotë më fal, por jo më përpara", apo, "Kam të drejtë të lridhërohem deri sa të vijë ajo kohë. Kur të më thotë më fal, do ta fal dhe çdo gjë do të jetë në rregull". Ti e mban të ngritur këtë mur hidhërimi dhe një ditë kur ai vjen dhe të thotë, "Më fal", ti nuk mund

ta falësh, sepse hidhërimi nuk fal. Me qëllim që ta falësh këtë person kur të vijë dhe të thotë më fal, duhet të jesh gati për këtë përpara se ai të vijë. Dhe në qoftë se je gati ta falësh përpara se ai të vijë, atëherë nuk varet nga kërkesa e tij për falje. Me fjalë të tjera ti heq qafe hidhërimin njëanshmërisht. Nuk ka rëndësi se çfarë bën personi tjetër.

Më përpara kemi thënë se hidhërimi duket të burojë nga mëkati i tjetrit, mëkat real ose imagjinar. Kjo është vetëm mënyra si shfaqet. Faktikisht hidhërimi është një mëkat që qëndron më vete. Personi i hidhëruar vendos të jetë i hidhëruar pavarësisht nga ofenduesi.

Ti thua: "Jo, ai mëkatoi kundër meje dhe kur të thotë më fal, do të rregullohet çdo gjë". Por kjo nuk është e vërtetë.

Kam njohur situata kur dikujt i është kërkuar falje dhe personi mbetet përsëri në hidhërim. Supozo se ofenduesi ka vdekur dhe nuk mund të kërkojë falje. Unë kam njohur njerëz të cilët janë jashtëzakonisht të hidhëruar dhe hidhërimi është ndaj prindërve të tyre të cilët kanë vdekur vite më parë. Por nuk ka vdekur hidhërimi i tyre. Hidhërimi është mëkat i vetëm personit të hidhëruar dhe nuk lidhet me asnjë tjetër. Njëherë shkova në burgun shtetëror në Uolla-Uolla, për të kaluar ditën me të burgosurit. Ishte koha e Krishtlindjes. Atje kalova afro 6 orë. Gjatë mbasdites ndodhesha në degën e sigurisë maksimale, dhe po flisja dhe u mësoja për ungjillizimin.

Dikush atje më pyeti se si mund t'u predikohet Ungjilli kriminelëve më të regjur. Unë mendova se ai ishte vërtet i interesuar për një ungjillizim të tillë dhe i fola për këtë. Pastaj kalova kohë në degët e sigurisë minimale, të rrojtjes mbrojtëse dhe disa vende të tjera. Në mbrëmje ndodhesha përsëri në degën e sigurisë maksimale dhe vendosa të flisja për këtë çështje të hidhërimit. E merrja me mend se atje me të ngjarë kishte disa njerëz të hidhëruar.

I njëjti person i cili pyeti për ungjillizim mbasditën, më bëri një pyetje tjetër. Ai tha: "Si mund të heqësh qafe hidhërimin për dikë që rrahu në dru djalin tënd 3-vjeçar?" Unë ia tregova se si dhe më pas i thashë: "Kur hiqni qafe hidhërimin tuaj, mund ta ndihmoni këtë person që të mos rrahë më fëmijë të tjerë të vëgjël".

Ai tha, - Jo, ky njeri nuk mund të ndihmohet.

- Sigurisht që po, - i thashë unë.
- Jo, jo.
- Pse jo?

— Ai nuk është më me ne.

Ky i burgosur e kishte vrarë atë. E kishte vrarë për atë që i kishte bërë djalit të tij 3-vjeçar. Për këtë arsye ishte futur në këtë burg. Dhe megjithëse e kishte vrarë njeriun, ai mbeti përsëri i hidhëruar. Me fjalë të tjera, të shprehurit atë nuk e hoqi.

Kur dikush tjetër thotë më fal, kjo nuk na e heq hidhërimin. E vetmja gjë që largon hidhërimin është rrëfimi para Perëndisë për hir të vdekjes dhe ringjalljes së Zotit Jezu Krisht. Kjo është e vetmja zgjidhje.

Nuk duhet ta mbajmë apo ta ndajmë hidhërimin me të tjerët. Duhet bërë vetëm një gjë, ta rrëfejme atë si një mëkat të madh e të keq duke qenë këmbëngulës në rrëfime sa të ketë nevojë.

Njëherë po flisja në Monterey të Kalifornisë, në Shkollën Detare Pasuniversitare të ShBA-së. Ishte një njeri që kishte nam të madh si mësues i Biblës. Ai ishte oficer në Flotë por kishte mbetur i pagraduar (megjithë aftësitë e tij). S'kishte komandimin e një nëndetëseje. Për këtë ishte hidhëruar. Unë fola për rrëfimin e mëkatit dhe hidhërimin dhe atij iu mbush mendja plotësisht. Erdhi më takoi dhe hoqi qafe krejt hidhërimin. Mëngjesin tjetër gruaja e tij më tha: "Kam një burrë të ri". Ai kishte qenë i hidhëruar me Flotën. Por ishte mëkati i tij dhe jo i Flotës.

Ejmi Karmajkëll (Amy Carmichael) bëri njëherë një koment se si një gotë e mbushur plotësisht me ujë të ëmbël nuk do të zbrazë qoftë edhe një pikë ujë të hidhur, sado befaz e trondit. Në qoftë se gota është plot me ujë të ëmbël dhe tronditet, çfarë do të dalë prej saj? Ujë i ëmbël. Në qoftë se i jep një tronditje më të fortë, çfarë do të ndodhë? Do të zbrazet më tepër ujë i ëmbël. Në qoftë se dikush është mbushur me ujë të ëmbël dhe dikush tjetër i jep një tronditje, çfarë do të dalë? Ujë i ëmbël. Tronditjet nuk e kthejnë ujin e ëmbël në ujë të hidhur. Kjo shkaktohet nga diçka tjetër.

Tronditjet nxjerrin prej mbajtëses atë që është tashmë brenda saj. Në qoftë se ti je i mbushur me ëmbëlsi dhe dritë dhe tronditesh, atëherë do të derdhësh ëmbëlsi dhe dritë. Në qoftë se je i mbushur me mjalhtë, mjalhtë do të dalë jashtë. Po në qoftë se del jashtë uthull, çfarë provon kjo? Kjo tregon se çfarë ishte tashmë në mbajtësen. Me fjalë të tjera hidhërimi nuk bazohet aspak në atë që bëri tjetri. Ajo është pasojë e asaj që ne bëjmë dhe e asaj që jemi vetë.

Shumë vite më parë, po punoja në dhomën tonë të gjumit në tryezën time. Gruaja ime Besi po lexonte në shtrat. Ajo që po bëja (çfarëdo ishte) nuk po shkonte mirë. Besi më tha diçka dhe unë u ktheva drejt saj dhe e qortova rëndë. Veprimi im ishte një veprim prej jobesimtari. Ajo më pa me habi,

u ngrit dhe doli nga dhoma. Unë qëndrova atje duke menduar: "S'duhet të ma kishte thënë këtë. Shiko çfarë më tha. Shiko, shiko, shiko". Këtë e bëra për 10 minuta, ndoshta më gjatë. Isha i hidhëruar me Besin, kurse ajo veçse tundi gotën dhe ç'ishte në gotë doli.

Në qoftë se kisha qenë i mbushur me ëmbëlsi dhe dritë, nuk do të kishte ndryshuar gjë. Kështu mendova ndërsa isha i ulur atje dhe shkova nëpër mend çfarë bëri ajo. Nuk duhet të mendohesha ashtu, sepse tashmë e kisha mësuar këtë të vërtetë për hidhërimin. Megjithatë, unë akoma mendoja për "mëkatën e saj" sepse njeriu ndien kënaqësi në akuzimin e dikujt tjetër. Këtë e bëjnë disa njerëz për vite të tëra.

Qëndrova atje për një kohë, pastaj u ngrita dhe kalova tek ana tjetër e shtratit, u ula më gjunjë dhe u luta: "Zot, unë isha i vetmi në gabim. Ishte hidhërimi im dhe mëkati im. Po e rrëfej atë, të lutem më fal, unë po e braktis këtë hidhërim e mëkat".

U çova prej më gjunjë dhe thashë me vete: "Prapëseprapë ajo më tha...?!" U ula përsëri më gjunjë.

"O Zot, më fal për atë që bëra. Unë e pranoj përgjegjësinë. Ishte mëkati im dhe vetëm i imi".

U çova prej më gjunjë përsëri dhe thashë: "Perëndi, Ti dhe unë e aimë se i kujt ishte vërtet gabimi". Rashë përsëri më gjunjë. Qëndrova ashtu për 45 minuta derisa mund të ngrihesha pa thënë: "Pa shih se çfarë tha ajo?!"

Tani nuk më kujtohet se çfarë tha dhe as se çfarë po bëja në tryezë. Nuk më kujtohen hollësit. E vetmja gjë që kujtoj është ngritja. Por di gjithashtu se po të mos kisha hequr qafe hidhërimin, *do ta dija saktësisht deri në sot se çfarë kishte thënë ajo*. Është kjo natyra e hidhërimit.

Me qëllim që të heq qafe hidhërimin, unë duhet të kuptoj se ai është i lig dhe sepse është mëkati im dhe vetëm imi. Nuk mund të largoj hidhërimin me anë të të kërkuarit falje të tjetrit. Nuk mund të heq qafe hidhërimin në qoftë se personi tjetër heq dorë (nga grindja) apo vdes. Nuk mund ta largoj atë në asnjë mënyrë tjetër përveç se ta quaj mëkat kundër Perëndisë së Shenjtë, ta rrëfej atë dhe të marr faljen.

Vështirësia qëndron në të larguarit sytë e mi nga mëkati i tij. Por thjesht fakti që unë mendoj se është problemi i tij, tregon se nuk është ashtu. Po të ishte problemi i tij, unë do të isha i mbushur me ëmbëlsi dhe dritë, jo i hidhëruar, dhe atëherë do të interesohesha për tjetrin.

Unë mund të thosha: "Ah i gori ai! Shiko çfarë bëri! Në qoftë se do të bëja diçka si ai, do të ndihesha shumë keq. Ai me të vërtetë duhet të ndihet

shumë keq. Mendoj se do të shkoj ta ndihmoj". Por, në qoftë se reagimi im nuk është i tillë, atëherë jam i hidhëruar dhe mëkati është imi dhe jo i tiji.

Unë besoj se ky mëkat është një pengesë e madhe për rilindjen e shumë njerëzve që jetojnë në errësirë shpirtërore kudo që ndodhen. Kur besimtarët fillojnë të rrëfejnë mëkatet e tyre, atëherë do të kenë mundësinë t'ua falin mëkatet të tjerëve.

"Kështu do të veprojnë me ju edhe Ati im qiellor, në qoftë se secili prej jush nuk e fal me gjithë zemër vëllanë e vet për fajet e tij"

Mateu 18:35

Këtu po flet Zoti Jezu Krisht, kur po u jep nxënësve të Tij mësimin për faljen. Shumë prej nesh e kanë provuar kur dikush ka ardhur dhe na ka kërkuar falje. Herë tjetër kemi shkuar ne të kërkojmë falje. Ka disa përgjigje të zakonshme për kërkesa të tilla, por ajo që dëgjohet më shpesh është se s'ka ç'të falësh. Kjo duket shumë bujare, por nuk është vërtet kështu. Kjo është një nga mënyrat për të refuzuar faljen.

Personi që ti kërkonte të të falë e di mjaft mirë se ke nevojë të falesh. Por përsëri ai i shmanget kërkesës duke nxjerrë frazën: "Oh, s'ka përse". Ai mund të mendojë vërtet se nuk kishte asnjë problem, por zakonisht nuk është kështu.

Nganjëherë thonë: "S'ka gjë, i falur qofsh". Ata e thonë këtë se duhet ta thonë, por kjo nuk është ajo që po thotë zemra e tyre. Por ky varg kërkon falje nga zemra. Me fjalë të tjera, e di Perëndia kush fal vërtet dhe kush nuk fal. Gjithashtu na thuhet se Perëndia do ta trajtojë secilin prej nesh në një mënyrë të caktuar në qoftë se nuk e falim bashkëbesimtarin tonë nga zemra. Ai nuk kërkon prej nesh të themi fjalët e duhura. Edhe në qoftë se mund të bindim personin që kemi përballë, nuk mund ta bindim Atë që kontrollon zemrat. Perëndia e di kur e kemi falur bashkëbesimtarin nga zemra.

Ne nuk mund t'i fshihemi Zotit kur mëkatojmë në këtë mënyrë. Zemrat tona janë të hapura dhe të shfaqura për Atë. Në qoftë se ne po refuzojmë të falim, atëherë këtë e di Ai. Ai e di mëkatin tonë, dhe sigurisht i di edhe kërkesat e Fjalës së Tij që kanë të bëjnë me faljen.

Pra, çfarë na mëson Bibla për sa i përket mënyrës se si do të na trajtojë Ati ynë qiellor?

"Atëherë Pjetri iu afrua dhe tha: «Zot, nëse vëllai im mëkaton kundër meje,

sa herë duhet ta fal? Deri shtatë herë?»"

Mateu 18:21

Ai mendoi se po bënte një pyetje të shkëlqyer.

"Jezui i tha: «Unë nuk të thet deri shtatë herë, por deri shtatëdhjetë herë shtatë»"

Mateu 18:22

A mendon se, kur Jezui tha këtë, Ai donte të kufizonte faljen në katërqind e nëntëdhjetë herë? A kemi për të numëruar? A na lejohet të mbajmë regjistër për gabimet?

Sa herë që dikush numëron sa herë ka falur, nuk ka falur vërtet. Në qoftë se fal vëllanë tënd nga zemra sa herë që ai mëkaton kundër teje, atëherë çdo herë do të të duket si e para.

Kur Jezui mëson për gjëra të tilla si p.sh. ktheni faqen tjetër, këtë njerëzit e keqpërdorin. Ata thonë: "Mirë, po e lejoj të më godasë në faqen tjetër, por në qoftë se më godet për herë të tretë, atëherë do ta stolis mirë".

Por kur Jezui mësoi për kthimin e faqes tjetër, po na mësonte ta bënim këtë nga zemra. Jezui supozoi se personi tjetër po mëkaton kundër teje. Ai supozoi se personi tjetër ka mëkatuar shtatë herë, ose shtatëdhjetë e shtatë herë ose katërqind e nëntëdhjetë herë. Por, në qoftë se ti po numëron, atëherë nuk po fal.

"Prandaj mluetëria e qiejve i ngjan njëmbreti qëdeshi tëbënte Ulogaritëme shërbëtorët e vet. Mbasi filloi t'i bëjë llogaritë, i sollën një që i detyrohej dhjetë mijë talenta. Dhe, duke qenë se ky nuk kishte të paguante, zotëria e tij urdhëroi që të shitej ai me gruan e tij, bijtë e tij dhe gjithë ç'kishte, dhe të shlyejë detyrimin. Atëherë ai shërbëtor i ra ndërkëmbë e i lutej duke thënë: «Zot, ki durim me mua dhe unëdo t'i paguaj tëgjitha». I shtyrënga dhembshuria, zotëria e atij shërbëtori e la të lirë atë dhe ia fali detyrimin.

Por ai shërbëtor, si doli, takoi një nga shërbëtorët e tjerë, që i detyrohej njëqind denarë; dhe, mbasi e zuri për fyti, po e mbyste duke thënë: «Më paguaj detyrimin që më ke». Atëherë shërbëtori shok i tij, i ra ndër këmbë dhe iu lut duke thënë: «Ki durim me mua, dhe do t'i paguaj tëgjitha». Por ai nuk deshi, madje shkoi dhe efuti në burg deri sa ta shlyente detyrimin.

Por shërbëtorët e tjerë, kur e panë ngjarjen, u pikëlluan shumë dhe shkuan e i thanë zotërisë së tyre gjithçka që kishte

ndodhur. Atëherëzotëria e tij e thirri dhe i tha: «Shërbëtor i lig, unë ta fala gjithëkëtëdetyrim, sepse m'u lute. A nuk duhej tëkishe mëshirëedhe ti për shokun tënd, ashtu si pata mëshirë unë për ty?» Dhe zotëria i tij, i zemëru-

ar, ua dorëzoi torturuesve deri sa të paguante gjithë detyrimin.

Kështu do të veprojë me ju edhe Ati im qiellor, në qoftë se secili prej jush nuk e fal me gjithë zemër vëllanë e vet për fajet e tij"

Mateu 18:23-35

Kur kaluam nga vdekja në jetë, u falëm, dhe borxhi që u la ishte shumë i madh. Kur u bëmë besimtarë morëm në atë kohë falje të pakushtëzuar. Ajo ishte dhuratë dhe e morëm të palidhur me kushte. E pra ka një ndryshim midis faljes së kushtëzuar dhe asaj të pakushtëzuar.

Kur u rilindëm sërish morëm falje të pakushtëzuar. Ajo ishte falje e madhe ashtu si falja e detyrimit të madh në shembëlltyrën.

Tek Kolosianët 3:13 shkruhet: "Duke duruar njeri tjetrin dhe duke falur njeri tjetrin, në qoftë se dikush ankohet kundër një tjetri; dhe sikundër Krishti ju ka falur, ashtu bëni edhe ju".

Pra, si na fali Krishti? Pa kushte, dhe na tregohet që **duhet të falim në të njëjtën mënjrë**. Duhet të falim pa kushte. Por kur vjen fjala për fajtorët tanë, ne këtë e bëjmë me kushte. Kujto si i trajton Ati ynë qiellor ata që sillen si shërbëtori i lig në shembëlltyrën.

"Dhe na i fal fajet tona, ashtu siç ua falim ne fajtorëve tanë"

Mateu 6:12

Zoti na drejtoi të luteshim në këtë mënyrë. Kurse ne protestojmë: "Perëndi, unë nuk dua të falem në këtë mënyrë. Në qoftë se falem sikundër fal, ky është një problem i madh për mua".

Besimtari që lutet siç drejtohet më sipër, lutet për falje të kushtëzuar. Tek vargu 14, menjëherë mbas lutjes Jezui thotë: "Në qoftë se ua falni njerëzve gabimet e tyre, Ati juaj qiellor do t'juaj falë edhe juve; por në qoftë se ju nuk ua falni njerëzve gabimet e tyre, as Ati juaj nuk do t'juaj falë juve gabimet tuaja". A është e vërtetë kjo? Është Zoti Jezu Ai që e tha këtë.

Dikush mund të kundërshtojë: "Si mund të jetë kështu? Ne kemi marrë falje të pakushtëzuar. Tani Jezui po thotë se në qoftë se unë i fal njerëzit kur mëkatojnë kundër meje, do të më falë mua edhe Ati im qiellor. Por në qoftë se unë nuk u fal njerëzve mëkatet e tyre, Ati im nuk do të falë mëkatet e mia. Më duket kjo tamam si f alje e kushtëzuar...?" Ja pse është e kushtëzuar. Ai tha se kur kaluam nga vdekja në jetë na u fal një borxh i madh.

Më pas na u dhanë drejtime shumë të qarta, të falim siç u falëm. Ishim falur pa kushte dhe na thuhet të falim pa kushte.

Në qoftë se dikush fal pa kushte, nuk ka probleme kur lutet kështu: "Zot më fal mua ashtu siç fal unë". S'do mend se kjo falje është e pakushtëzuar. Nuk ka kontradiktë për besimtarin i cili vepron siç i është thënë. Ka një kontradiktë të dukshme vetëm kur falja nuk ofrohet në të njëjtën mënyrë siç merret. Ky ishte problemi me shërbëtorin që nuk fali. Ai ishte falur dhe më pas u kthye dhe nuk fali ashtu siç ishte falur.

Kjo është një deklaratë e fuqishme: "Kështu do të veprojë me ju edhe Ati im qiellor, në qoftë se secili prej jush nuk e fal me gjithë zemër vëllanë e vet për fajet e tij". Në qoftë se nuk fal, ke një arsye të mirë të dyshosh se je i shpëtuar.

"Por në qoftë se vëllai yt ka mëkatuar kundër teje, shko dhe qortoje vetëm për vetëm; nëqoftë se të dëgjon, ti efitove vëllanë tënd; por nëqoftë se nuk të dëgjon, merr me vete edhe një ose dy vetë, që çdo fjalë të vërtetohet nga goja e dy ose tre dëshmitarëve. Në se pastaj refuzon t'i dëgjojë, thuaja kishës; dhe në qoftë se refuzon edhe ta dëgjojë kishën, le të jetë për ty si pagan ose tagrambledhës. Nëtëvërtetëju them segjitha gjërat qëdo tëkeni lidhur mbi tokë do të jenë lidhur edhe në qiell; dhe gjitha gjërat që keni zgjidhur mbi tokëdo të jenë zgjidhur edhe nëqiell. Poju them gjithashtu se, nëqoftë se dy prej jush bien nëujdi mbi tokë tëkërkojnë çfarëdo gjëje, kjo do t'ujepet atyre nga Ati im që është në qiej. Sepse, kudo që dy a trejanë bashkuan në emrin tim, unëjam në mes të tyre"

Mateu 18:15-20

Ky pasazh, i cili paraprin shëmbëlltyrën që kemi shqyrtuar, ka të bëjë gjithashtu me këtë falje prej zemrës. Në qoftë se vëllai yt mëkaton kundër teje, shko dhe tregoji gabimin e tij thjesht midis jush të dy. Në qoftë se të dëgjon, e ke fituar vëllanë.

Ti thua: "Por s'ka të ngjarë se do të ndodhë ashtu. E kam provuar këtë gjë. Ai ka mëkatuar kundër meje, dhe isha kaq i inatosur saqë shkova dhe ia tregova gabimet, por kjo nuk e bindi aspak". Kjo ndodh sepse nuk shkon me falje në zemër. Ky pasazh nuk ka shumë kuptim për shumë njerëz, sepse nuk e përfytyrojnë të shkuarit te dikush në këtë mënyrë. "Si mund t'i tregosh dikujt që ka mëkatuar kundër teje se çfarë të ka bërë dhe të shpresosh ta fitosh atë? Do të mbyllet ai".

Pse do të mbyllet ai? Sepse dikush po e akuzon. Por në qoftë se dikush shkon me falje në zemër (konkluzioni përfundimtar i gjithë këtij mësimi), atëherë nuk do të jetë akuzues rezultati.

Unë mund të garantoj se ai nuk do të fitohet dot si vëlla në qoftë se korrigjuesi i tij shkon me çfarëdo lloj hidhërimi, zemërimi apo fryme akuzuese. Korrigjuesi i tij nuk duhet të shkojë tek ai në këtë lloj gjendjeje. Na lejohet

të shkojmë tek ai vetëm kur në zemrën tonë ka falje përpara se të nisemi. Kjo falje të mos varet nga pendimi i tij. Unë mund të garantoj se ai nuk do të pendohet në qoftë se nuk i afrohem me falje nga zemra. Ne duhet të shkojmë me dashuri dhe falje. Në qoftë se na dëgjon, e kemi fituar vëllanë.

Por, në qoftë se ai nuk do të dëgjojë, megjithëse i jemi afruar në këtë mënyrë, duhet të marrim me vete një ose dy të tjerë, njerëz mefalje në zemrat e tyre. Kjo nuk është ajo që ndodh zakonisht.

Dikush shkon me një akuzë, tjetri fillon të mbyllet dhe nuk fitohet. Kështu mbledhen dy të tjerë, me të njëjtën anë të historisë, dhe vijnë dhe e përkrahin korrigjuesin fillimtar. As ata nuk kanë sukses.

Çdokush duhet të ketë falje në zemër, në mënyrë që kur të refuzojë të pendohet ofenduesi, atëherë do të jetë mjaft e qartë se ky është problemi i tij. Në qoftë se ai refuzon të dëgjojë, atëherë duhet t'i thuhet kishës. Kuptohet se është e nevojshme që edhe kisha të jetë plot me falje.

Ka kisha që mendojnë se ushtrojnë një disiplinë kishtare që i bie dakord vullnetit të Perëndisë. Nuk është ashtu, sepse mungon ky qëndrim. Ata shkojnë te ky person, ia ngarkojnë dhe ai refuzon. Ata marrin dy ose tre të tjerë, shkojnë dhe ia ngarkojnë dhe ai refuzon dhe ata. Kisha e përzë këtë njeri, por atje nuk ka falje në zemër. Kurse një nga qëllimet e disiplinës kishtare është ta mëkëmbë ofenduesin.

Në qoftë se ai refuzon të dëgjojë kishën, të trajtohet si pagan ose tagrambledhës. Nuk besoj se Zoti Jezu ka dashur të thotë ashtu si trajtoheshin faktikisht paganët ose tagrambledhësit. Besoj se Ai do të thotë se si duhet të trajtoheshin paganët ose tagrambledhësit. Më përpara, tek Mateu 5, Jezui na thotë t'i trajtojmë si të drejtët ashtu dhe të padrejtët aslitu siç e bën Ati, në mënyrë të barabartë.

Ai na thotë që të duam armiq të tanë. Kështu, edhe kur i trajtojmë si paganët apo tagrambledhësit, kemi përsëri një trajtim dashamirës. Kjo ka kuptimin thjesht që ata konsiderohen si të përjashtuar nga bashkësia, por me dashuri dhe falje nga zemra. Ata në asnjë mënyrë nuk e duan faljen që besimtarët ua ofruan prej zemrës. Pikërisht për shkak të këtij mësimi, Pjetri bëri pyetjen e cila e shpuri drejt shëmbëlltyrës: "Sa herë duhet ta fal vëllanë tim?"

Dashuria nuk mban mend gabimet (1 Kor. 13:4-7). Keni dëgjuar disa prej jush diçka të këtillë brenda martesës. Burri ose gruaja mund të thotë: "Ti gjithmonë bën këtë dhe kurrë nuk bën atë".

Ç'do të thotë kjo? Dikush po i numëron gabimet. Bibla thotë mos e bëj kurrë këtë. Mbahet një listë e gabimeve kur dikush grumbullon shkeljet.

Kurse falja nuk e bën këtë.

Çfarë donte të thoshte Jezui kur tha tek Mateu 18:18 "Gjitha gjërat që do të keni lidhur mbi tokë do të jenë lidhur edhe në qiell"? Kjo flet për kishat e krishtere, plot falje, të cilat veprojnë në emër të Zotit Jezu Krisht. Ato po veprojnë ashtu siç u tha Ai të veprojnë. Pra, kur ato marrin një vendim të bazuar në Fjalën e Tij, Ai e nderon atë vendim.

Ai nuk nderon atë që kisha zbaton si formulë mekanike. Por në qoftë se është bërë me karakterin dhe dashurinë e Zotit Jezu Krisht dhe trupi i besimtarëve që falin merr një vendim për të disiplinuar ndonjë që nuk ka dëshirë të pendohet, Perëndia e nderon atë vendim në qiell.

Shumë besimtarë e përdorin **jashtë kontekstit** vargun tek Mateu 18:19 që ka të bëjë me dy ose tre që bien në ujdi. Vargu ka të bëjë me disiplinën kishtare dhe me faljen e vëllait tuaj. Ajo gjendet mu në mes të historisë që tregoi Jezui dhe pyetjes së Pjetrit sa herë duhej të falte ai. Kështu, kur mbledhen së bashku dy ose tre në emrin e Tij, Zoti Jezu Krisht është me ta. Kjo ka të bëjë me vendimet për faljen e të tjerëve që kanë mëkatuar kundër teje.

Mund të kuptosh marrëdhënien midis kësaj dhe hidhërimit. Hidhërimi është në fakt mosfalja. Është të thuash se dikush të bëri diçka dhe nuk do ta falësh. Por natyrisht, hidhërimi nuk mendon se është mëkat në vetvete, ai mund të shikojë vetëm mëkatin e tjetrit.

Kështu sipas njërit kuptimi, falja është e njëanshme. Në këtë kuptim Jezu Krishti na fali të gjithë përpara se penduam. Kjo nuk ishte në veprim derisa ne e morëm atë. Por Perëndia nuk ishte lart në qiell duke mbajtur një mëri derisa ne arritëm t'i shtroheshim punës së pendimit. Ai nuk është atje duke qëndruar në hidhërim gjersa ne të pendohemi. Ai ka falje në zemrën e Tij përpara se ta përvetësojmë ne. Ka një falje të njëanshme në anën e Perëndisë, dhe Ai kërkon që edhe ne të falim njëanshmërisht cilindo që ka mëkatuar ndonjëherë kundër nesh. Ne mendojmë çfarë na bëri ose na tha tjetri, kurse prapëseprapë tërë kjo çështje nuk ka të bëjë me atë që bëri apo tha tjetri.

Kur një besimtar fal nga zemra, atëherë është i interesuar për personin që mëkatoi kundër tij. Pra, nuk është i interesuar për veten e tij. Por ne jemi si Pjetri. "Mirë, Zot. Unë do ta fal atë shtatë herë, por në qoftë se bën të tetën, qenka në një goxha ngushticë!"

Por falja e vërtetë nuk mban llogari. Në qoftë se ke tendencë të mbash llogari brenda ose jashtë familjes, ka shumë tëngjarë që nuk po fal. Dhe Jezu Krishti tha se Ati i Tij; qiellor do ta trajtojë secilin prej nesh me një mungesë

faljeje në qoftë se nuk falim nga zemra. *Fale nga zemra vëllanë tënd.*

"Por unë nuk kam falje në zemrën time". Atëherë kush ka nevojë për falje?

Ai që ka nevojë për falje është po ai që ka këtë mosdashuri, këtë urrejtje, këtë qëndrim të keq, këtë mëri apo çfarëdo qoftë. Nuk mund t'i kesh të dyja. Nuk mund të kesh mosfalje në zemër dhe të gëzohesh në Zotin.

Është e mundur që të kesh mosfalje në zemër dhe përsëri të shkosh në kishë dhe të këndosh. Mirëpo s'është gjë tjetër përveç hipokrizisë kjo!. Është i rremë të kënduarit. Ti mund të bësh njerëzit të këndojnë, por kur ata janë të pastër nuk ke nevojë të bësh të këndojnë, sepse do të këndojnë vetë duke u nxitur nga zemra e plotë. Pse? Sepse kanë një zemër të pastër.

Ka ndryshim të madh midis të kënduarit ngaqë je duke u gëzuar në Zotin dhe të kënduarit që të marrësh gëzimin. Disa të krishterë shkojnë në kishë çdo të dielë dhe këndojnë që të marrin gëzim. Gëzimi merr fund kur pushojnë së kënduari sepse në zemër kanë papastërti.

Të gjithëve na pëlqen të mendojmë se ne jemi personi që ka të drejtë dhe se personi tjetër është fajtor. Por mund të mos jetë kështu. Thjesht kupton se je pikërisht ti ai personi që ka problemin e mungesës së faljes.

Në qoftë se një i krishterë ka falje në zemër, ai do të gëzohet, pavarësisht se sa ishte në gabim personi tjetër, ose sa mëkatoi kundër tij.

Por si mund të tregosh falje për dikë kur duhet të jesh shumë këmbëngulës sepse nuk beson në mënyrën e jetesës së tij? Nuk është në fakt kaq e vështirë. Në qoftë se ke falje në zemër, ai do ta dijë këtë pavarësisht se sa këmbëngulës je ti. Ai do të dijë duke u bazuar në tonin tënd. Njerëzit mund ta dallojnë kur ti i do. Ata mund të dallojnë edhe kur ti nuk epesh për shkak të hidhërimit që ke dhe mund ta dallojnë kur e bën për hir të dashurisë. E vetmja gjë që duhet ta kesh të sigurt është qëndrimi yt në bashkëbisedimin. Nuk ke nevojë të shqetësohesh si do të reagojnë ata. Rezultatet i takojnë Zotit. Ata mund të mos e pranojnë faljen tënde, por ndryshimin e dinë.

Herë pas here më është dashur të jem shumë këmbëngulës me njerëzit. Tridhjetë e një vjet më parë një burrë u pajtua me

Zotin qysh në mars të mëparshëm. Ai kishte qenë besimtar që në vitin e parë të kolegjit, por në vitin e fundit ai u vu vërtet në raport të drejtë me Zotin. Kërkoj të jetonte me ne në shtëpinë tonë gjatë verës pas diplomimit. Ne i çuam fëmijët në vend tjetër dhe e shpërngulëm në shtëpi. Së pari, ai shkoi në shtëpinë e vet dhe më pas u kthye. I transferoi të gjitha plaçkat në

shtëpinë tonë në qershor. Gruaja ime po vinte fëmijët në krevat, kurse ne ishim të dy në dhomën e ndenjes në katin poshtë. E pyeta si po i shkonin punët. Ai tha: "Jo aq mirë".

- A është ai i njëjti problem që ke pasur më përpara?
- Po.
- E njëjta vajzë?
- Po.

Unë e pyeta nëse mund ta kujtonte sa mrekullisht e fali Perëndia marsin e kaluar.

- Ishte mrekulli. Kisha gëzim dhe paqe të madhe, - u përgjigj.
- Mirë. Ai mund ta bëjë këtë përsëri. Le të lutemi që tani. Ti mund të pendohesh, rrëfesh dhe përtëritesh, - i thashë.
- Jo-
- Mirë. Por është e vërtetë.
- Po e di, e kam parë se kështu ndodh. E di se Ai do ta bëjë atë përsëri, por unë nuk jam gati tamam, - m'u përgjigj.
- Mirë, por kam mendimin se nuk më kupton. Ti nuk ke tjetër zgjedhje. Ti e di se duhet të përtërihesh tani.
- Jo, do ta bëj herë tjetër, por jo tani.
- Mirë, unë mendoj se duhet t'i tregoj kishës që po jeton në mëkat, - i thashë.
- Do t'i thuash kishës atë që ta thashë në mirëbesim?
- Unë nuk e dija se ishte në mirëbesim, nuk e dija se çfarë do të më tregojë, madje nuk e dija se do të mbeteshe i papenduar pasi ma the. Perëndia më thotë t'ia parashtoj kishës këtë, sepse nuk duhet të shoqërohemi me ty. Nuk do të hamë me ty. Bibla na tregon se çfarë duhet të bëjmë me të gjithë ata që e quajnë veten vëllezër dhe kryejnë marrëdhënie para martesës. Kisha nuk ka zakon të fortë të veprorë sipas vullnetit të Perëndisë, kështu që mbase do të më përzërë për thashetheme. Megjithatë, Bibla më thotë që t'i tregoj kishës. Do t'i tregoj gjithashtu organizatës "Bashkimi i Oficerëve të Krishterë" dhe atyre nuk do t'u dridhet syri. Do të të largojnë aq shpejt sa të mos ia bëjmë dot sehir, * përfundova.

Ai u nxehtë.

Unë i thashë se kishte edhe një problem tjetër. - Tek 1 Korintasit 5, thuhet se ne të mos hamë me ty. Thjesht ne nuk lejohe mi të mbajmë shoqëri me njerëz imoralë të cilët quajnë veten besimtarë. Në qoftë se dikush e quan veten vëlla dhe jeton në këtë mënyrë, neve bile as na lejohet që të hamë bashkë me të. Kurse ti dëshiron që të mos i bindem Perëndisë, sepse je i vendosur të qëndrosh i papënduar. Dëshiron që unë të ha me ty dhe të mbaj shoqëri me ty sa të mbetesh i papënduar. Tani i ke futur brenda plaçkat, kështu që mund të qëndrosh një natë. Por në qoftë se nuk vihesh në raport të drejtë me Zotin para mëngjesit, dua të ikësh nga shtëpia përpara se të hahet mëngjezi dhe nuk dua të flasësh as me gruan as me fëmijët e mi.

Ai u inatos shumë.

— Të dua shumë, — i thashë. — Ti e di që të dua shumë. Mund të qëndrosh këtu gjatë gjithë beharit po të ndodhesh në shoqëri me ne, por s'ke për të ngrënë mëngjez këtu nesër në qoftë se nuk ndodhesh në shoqëri.

Ai e dinte që e doja dhe nuk mbaja mëri kundër tij. E dinte se dashuria ime ishte e vërtetë. Por, në qoftë se e njëjta gjë do t'i thuhej nga unë me ndonjë lloj keqdashjeje të hidhëruar, do të kishte qenë gabim.

Ai u vu në raport të drejtë me Perëndinë para mëngjesit dhe qëndroi me ne gjatë gjithë beharit. Kështu, falje nuk është në kundërshtim me një disiplinë që bëhet sipas vullnetit të Perëndisë. Në qoftë se ekziston disiplina, kjo nuk do të thotë se na mungon falja.

Kalo kohë i vetëm me Perëndinë dhe pastro jetën. Në qoftë se ke mos-falje për dikë tjetër, atëherë fale atë nga zemra. Perëndia, mjaft shpejt, do të të pranojë. Ai të fal shumë shpejt.

2. Inati i njeriut

nga Heather Wilson Torosoglu

Zoti i tha Kainit: «Pse je pezmatuar dhe pseyfytyra jote është dëshpëruar?

Në rast se bën mirë a nuk do të pranohesh?»

Dikush sapo të ka goditur rëndë makinën dhe të ka hipur inati. Ai është një 16-vjeçar që po ngiste makinën si i marrë. Të ka hipur inati dhe shfryn jo vetëm ndaj djalit por ndaj gjithë brezit të tij dhe ndaj këtij sistemi që lejon këta njerëz kaq të papërgjegjshëm të dalin nëpër rrugë. Dhe, si për të të bërë të pëlçasësh nga inati, të afrohet ndonjë i krishterë dhe të thotë të largosh çdo inat dhe zemërim. E po, kjo s'mund të durohet dhe ti mendon: "Banalitete! Është kollaj që të flasë kështu. Pastaj, Bibla na thotë se mund edhe të inatosemi. U inatos Jezui kur dëboi nga Tempulli shkëmbyesit e parave. Fundja, të mbash inatin brenda të bën keq; më mirë të tregohesh ashtu siç ndihesh se të bëhesh hipokrit".

E kështu vazhdojnë e vazhdojnë justifikimet. Përpiqesh ta bindësh veten se kishe të drejtë të nxeheshe. Këto justifikime mendoj se të gjithë pa përjashtim i kemi dëgjuar, dhe me shumë të ngjarë, edhe t'i kemi përdorur. Në qoftë se ndokush është kaq budalla sa të përpiqet të na tregojë se inati nuk është ai që Perëndia do të donte që ne të kishim, ne thjesht ua shtojmë atë të gjitha arsyeve të tjera për t'u inatosur.

Disa njerëz inatosen për gjëra që do t'i quaje çikërrima (d.m.th. ato gjëra të cilat s'të bezdisin): paaftësia në punë; dikush futet shpejt para teje dhe të zë vendin ku ti po bëheshe gati ta parkoje makinën; mënyra se si një bashkëshort i lë çorapet më dysheme, apo gruaja që e ka zakon të vonohet. A nuk është e habitshme kur shikon se ç'i bën njerëzit të nxehen vërtet?

Të tjerë mund të inatosen për "gjëra më të mëdha" të tilla si zia e bukës në botë, aborti, lufta, mohimi i të drejtave të njeriut, apo diskriminimi. Ka kaq e kaq arsye për të cilat njerëzit mund të shpërthejnë, arsye këto që janë po aq unike sa edhe gjurmët e gishtave. Por cilado qoftë këmbëza jonë, Bibla thotë ca gjëra shumë të vendosura për inatin.

Justifikimi më i shpeshtë është ky: "Bibla na thotë tëzemërohemi". Po, vërtet ajo thotë: "Zemërohuni..." (Efes. 4:26). Por me kaq mjaftohen njerëzit shpeshherë. Ata qëllimisht nuk e vënë re fare pjesën që vijon që thotë: "...dhe mos mëkatoni".

Besimtarët shpesh e dinë shumë mirë pjesën e parë të urdhrit, por tjetrën as që e vënë re. Urdhrit i shton vargu edhe një kusht të dytë: "Dielli të mos perëndojë mbi inatin tuaj".

Ka edhe vargje të tjera të cilat mund të interpretohen sikur na lejojnë të zemërohemi. "Çdo njeri të jetë i shpejtë në të dëgjuar, i ngadalshëm në të folur dhe i ngadalshëm në zemërim...". Përsëri, kjo na tregon se në qoftë se nuk shpërthejmë, gjithçka është për së mbari. Por përsëri fraza që pason hedh dritë të mëtejshme mbi këtë çështje: "...sepse zemërimi i njeriut nuk kryen drejtësinë e Perëndisë" (Jakobi 1:19-20).

Mbase do të ishte e rregullt atëherë të zemëroheshim në qoftë se:

1. nuk mëkatojmë.
2. nuk biem të flemë me këtë zemërim.
3. ky është prej Perëndisë dhe jo prej njeriut.
4. arrin të zbatojë të drejtën.
5. jemi të ngadalshëm në zemërim.

A mos mendon se në qoftë se përmbushen të gjitha këto kërkesa, atëherë zemërimi do të zvogëlohet shumë?

Një pjesë tjetër e Biblës së cilës i bëhen referime është ajo kur Jezui e pastron Tempullin (Mateu 21, Gjoni 2). Ky është pasazh i vështirë të përdoret për provën e pretendimit, pasi zemërimi ynë është shumë rrallë kaq i drejtë. Edhe pse pasazhri nuk na thotë asnjëherë se Jezui ishte i zemëruar, ne përsëri mund ta shohim se si i plotëson të paktën katër prej pesë kërkesave.

Zemërimi i Tij dukej që ishte i Perëndisë pasi shihej që ai nuk kishte për qendër vetveten. Ai po pastronte Tempullin e Perëndisë. Pasoja e kësaj gjëje ishte drejtësia. Meqë ishte prej Perëndisë, nuk ishte mëkat. Erdhi atëherë ngadalë sa për ta lejuar Atë të bënte një kamxhik. Dhe në qoftë se na pëlqen, edhe mund ta pranojmë se, Atë muzgu nuk e zuri me këtë inat.

Në qoftë se nuk mund ta krahasojmë dot inatin tonë me atë të Krishtit, ne mund ta përdorim thënien: "E ku kupton gjë ti more?" Mbase unë nuk kuptoj, por Krishti sigurisht që të kupton, pasi "ne nuk kemi kryepriфт që nuk mund t'i vijë keq për dobësitë tona, po një që u tundua në të gjitha ashtu si ne, por pa mëkatuar" (Heb. 4:15). Krishti i kupton dobësitë tona, por jo vetëm kaq. Ai na jep hir, që të kemi ndihmë në kolrë nevojë (vargu 16).

Po sikur të tregohemi pak më të sofistikuar dhe të themi se, psikologjik-

isht, ëslitë më mirë ta shfrehmë zemërimin? Zemërimi i grumbulluar ka mundësi të kthehet në ulcera. Po natyrisht, në qoftë se e lëshojmë zemërimin tonë, mund të marrin ulcerat të tjerët. Shumë rrallë njerëzve u shkon në mendje se mund të ketë edhe një zgjedhje të tretë, d.m.th. t'ia dorëzojmë zemërimin tonë Perëndisë. Kjo nuk do të thotë të shfrehmë dufin tonë ndaj Perëndisë ("çiltëria"), por të pranojmë para Perëndisë se jemi të zemëruar, se në qoftë se kjo gjë nuk do të vendosë drejtësinë e Tij, nuk ka pse ta duam. Me këtë rrëfim, na hiqet inati ynë dhe mund të vazhdojmë jetën në gëzimin që na jep Perëndia dhe askush nuk vuan nga ulcera.

Shkrimet kanë vetëm këto pak tregues se nuk ka ndonjë gjë të keqe të zemërohesh në rrethana të veçanta, por ato na thonë shumë më tepër për marrëzimin e zemërimit dhe të qenët e tij mëkat.

"Tani hiqni edhe ju të gjitha këto gjëra: zemërim, zemëratë, ligësi..." (Kol. 3:8). "Mëritë dhe zënkat" numërohen si dy nga veprat e natyrës mëkatore tek Gal. 5:20. "Njeriu zemërak kurdis grindje dhe njeriu idhnak kryen shumë mëkate" (Fjalët e Urta 29:22). "...Ai që rrëmbehet me lehtësi vë në dukje marrëzinë e tij" (Fjalët e Urta 14:29). Fjalët e urta kanë kaq shumë për të na thënë mbi këtë temë.

Le të supozojmë tani se u binde që inati yt nuk është prej Perëndisë dhe se ke dëshirë të shpëtosh prej tij. Nga duhet t'ia fillosh? Së pari, është mirë të kuptosh se nga rrjedh inati yt:

"Njeriu i mirë nxjerr të mirën nga thesari i mirë i zemrës së vet; dhe njeriu i mbrapshtë e nxjerr të mbrapshta nga thesari i keq i zemrës së vet, sepse goja e njerit flet nga mbushullia e zemrës"

Luka 6:45

Këtu ne shikojmë se frutat e jetës sonë përftohen nga gjendja e zemrës sonë. Në qoftë se zemra jonë është e mbushur me të këqija, të këqijat do të dalin prej saj. Në qoftë kështu, duhen marrë dy hapa. I pari na shprehet tek Psalmi 139:23-24:

*"Më heto, o Perëndi, dhe njihe zemrën time,
më provo dhe njihi mendimet e mia.
Dhe shiko nëse ka tek unë ndonjë rrugë të keqe
dhe më udhëhiq nëpër rrugën e përdetshme"*

Të gjithë neve na nevojitet ky shqyrtim i zemrës sonë nga Perëndia. Hapi i dytë është t'ia rrëfejme Perëndisë mëkatet e zemrës sonë. "Por, po të ecim në dritë, sikurse Ai është në dritë kemi bashkësi njeri me tjetrin, dhe gjaku i Jezu Krishtit, Birit të Tij, na pastron nga çdo mëkat... Po t'i rrëfejme mëkatet tona, Ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi" (1 Gjoni 1:7,9). Inati do të zhduket nga zemrat tona

ashtu si shkëmbyesit e parave nga Tempulli.

Dhe sapo zemra të na jetë pastruar, duhet ta mbushim me çdo lloj gjërash të mirë. Ato që janë të vërteta, të ndershme, të drejta, të pastra, të dashura, me famë të mirë, siç na sugjeron edhe Pali tek Filipianët 4:8. Kjo mund të përkufizohet edhe si përtëritje e mendjes (Rom. 12:2).

Mos vallë lënia mënjane e çdo inati të duket si diçka e pashpresë dhe e pamundur? Në qoftë se do të varej vetëm nga ne që të përmbanim gjithçka në mënyrë të përsosur, natyrisht që do të ishte e pamundur. Por ta falënderojmë Atë se nuk është ashtu.

"Dhe Atij që mund t'ju ruajë nga çdo rrëzim dhe t'ju nxjerrë para lavdisë së Tij të paqortueshëm dhe me gëzim....Amen"

Juda24

3. Inatosja ndaj fyerjes

nga Heather Wilson Torosoglu

E dimë nga letra e Jakobit se ai që përmban gjuhën është gati i përsosur. Ai është i aftë të përmbajë gjithë trupin e tij. Por problemi qëndron në faktin se ka kaq shumë njerëz jo të përsosur që nuk kanë mësuar akoma t'i vënë fre gjuhës. Dhe kështu, anembanë, njerëzit vazhdojnë të lëndohen nga ato që thonë të tjerët.

Nuk është vetëm gjuha ajo që lëndon, por edhe veprimet. Kështu miqtë dhe të njohurit tanë jo vetëm që duhet t'i vënë fre gjuhës së tyre, por të dinë gjithashtu ta zbatojnë këtë edhe me trupin e tyre.

Për një arsye apo tjetrën ne ia ngarkojmë tërë përgjegjësinë fyesit dhe jo të fyerin. Nuk dua të justifikoj atë që nuk përmban gjuhën e tij. Duhet të përmbahet gjuha. Por deri sa të bëhet kjo, mos vallë kam të drejtë të lëndohem? A duhet të mbetem pre i lëndimeve derisa të gjithë të bëhen të përsosur? Mua më duket si më e paefektshmja e dy rrugëve për të arritur të njëjtin rezultat.

Do të na pëlqente që përreth të kishim njerëz kaq të mirë ndaj nesh tërë kohën, sa të mos kishim kurrë asnjë rast që ne të lëndohemi. S'do mend që kjo nuk është gjë tjetër veçse një ëndërr, kështu ajo që e sugjeroj unë është kjo: i fyeri të bëhet i fortë.

Një nga mënyrat që do të këshilloja për t'ia arritur kësaj gjëje do të ishte të shikoje shembullin që na dha Krishti.

"I përçmuar dhe i hedhur poshtë nga njerëzit, njeri i dhembjeve, njohës i vuajtjes, i ngjashëm me dikë para të cilit fshihet faqja, ishte përçmuar, dhe ne nuk e qmuaam aspak... I keqtrajtuar dhe i pëndur, nuk e hapi gojën"

Isaia 53:3,7

Kushdo prej nesh që do të ndodhej në të njëjtat rrethana do të mendonte se i kishte gjithë të drejtat për të qenë i lënduar. Do të mendonim: "Në qoftë se ata do të tregohen të tillë,

- 1) as që kam për t'u folur më,
- 2) as do të jem i mirë me ta përsëri,
- 3) as do t'i fal më dhe

4) as që të vdes për ta".

Sidoqoftë, sikur ky të kishte qenë reagimi i Zotit tonë, Ai kurrë nuk do të kishte shkuar drejt kryqit. E pranoj se ky ishte një rast i veçantë. Ai pati vërtet në dispozicion të gjithë fuqinë e Perëndisë. Ai është i përsosur dhe ne jo.

"Kini në ju po atë ndjenjë çjë ishte në Jezu Krishtin, i cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë, por e zbrazti veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit; dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme posi njeri, e përuli vetveten duke u bërë i bindur deri në vdekje, deri në vdekje të kryqit"

Filip. 2:5-8

Duke përmbledhur, ne duhet të kemi një mendje që i ngjan asaj të Krishtit në këto katër aspekte:

1. Të mos mbahemi pas identitetit apo të drejtave tona.
2. Të heqim dorë nga vetja.
3. Të kemi një zemër për të shërbyer.
4. Të jemi të përlulur.

Duke pasur një qëndrim të tillë ne mund gjithashtu "ta durojmë kryqin duke e përcëmuar fyerjen... për gezimin që është përpara nesh" (Heb. 12:2).

Zakonisht janë më të afërtit për ne ata që mund të na lëndojnë më rëndë. Një i huaj kurrë nuk mund të na lëndojë ashtu siç mundet burri apo grua, miku, vëllai apo motra. Kur lëndohemi prej dikujt ne themi me vete: "Në qoftë se më donte vërtet, nuk do të kishte folur kështu".

Por duke analizuar këtë thënie, zbulojmë se për kë mendojmë ne në të vërtetë. Mos mendojmë për mungesën e dashurisë tek personi tjetër dhe si kërkon ndihmë? Jo, po mendojmë se si na cenon kjo mungesë e dashurisë tek ai. Me fjalë të tjera jemi mendjemëdhenj - mendojmë vetëm për veten tonë, dhe se si lidhen me të veprimet e çdo njeriu tjetër.

Një pasazh shumë i dashur mbi dashurinë është 1 Korintasit 13. Dashuria këtu na përshkruhet si diçka që "nuk kërkon të sajat, nuk pezmatohet dhe nuk dyshon për keq".

Ne ndihemi të lënduar pasi nuk jemi të gatshëm të falim. Falja, sipas natyrës së vet, nuk i numëron të gabuarat. Tek Efesianët 4:32, një varg mjaft i njohur por shumë pak i zbatuar në jetë, Pali na thotë: "Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin". Ne duhet patjetër të falim ashtu siç

jemi falur. Kini parasysh 70 x 7. Nuk ka kufi për faljet tona, dhe natyrisht asnjë limit në aftësinë e Zotit për të falur.

Duke pasur parasysh se për çdo tundim Zoti na tregon një rrugë shpëtimi s'ka pse të lëndohemi përsëri. Kjo duket si një kërkesë e vështirë, siç e di, dhe shumë mund të thonë se është e pamundur. Por unë besoj se, në qoftë se Zoti premtoi një rrugë shpëtimi, kjo do të gjendet gjithmonë.

4. Fre gjuhës

nga Chris Vlachos

Para pak kohësh, në shtetin e Nju Jorkut, pati një shtrëngatë magnetike. Kjo shtrëngatë bëri që një bisedë telefonike të trazonte me valët e radios që po nxirreshin nga një radiostacion që ndodhej aty pranë. Si rezultat, biseda u përhap në radio pa dijeninë e të dy personave që po flisnin. Ishte një program që dëgjohej në mbarë Amerikën!

Të gjithë ne, në mos njëherë herën tjetër, jemi bërë fajtorë për thashetheme. Megjithatë kjo është një mëkat mjaft serioz në sytë e Perëndisë, mëkat nga i cili Ai dëshiron të heqim dorë.

Pali na flet për thashetheme tek 1 Timoteu 3:11 "Edhe bashkëshortet e tyre të kenë dinjitet, jo shpifarake, por të përmbajtura dhe besnike në gjithçka".

Që të mos mendojmë se burrat janë të imunizuar ndaj kësaj sëmundjeje, Pali u drejtohet atyre tek 2 Timoteu 3:3, ku parashikon se në ditët e fundit të vështira njerëzit do të jenë "...të padhembshur, të papajtueshëm, shpifës, të papërmbajtur, mizorë, që s'e duan të mirën".

Fjala greke që e përdor Pali në të dy rastet është fjala *diabolos*, fjalë e njohur kjo prej së cilës rrjedh fjala shqipe djall. S'është fare e nevojshme të shohim kalendarin tonë të shenjtoreve për të parë se kush është përkrahësi i shpifjeve dhe thashethemeve!

Diabolos është fjala që përkthehet nganjëherë edhe shpifësi. Thashethemet janë shpifja. Në vargun e mësipërm të cituar nga 2 Timoteu, Pali e vendos shpifjen në mes të një liste praktikash të tjera mjaft të këqija. Mjaft qartë na tregohet se sa serioze është kjo gjë.

Për fat të keq, shpesh është mjaft e vështirë të diktojmë thashethemet në veten tonë. Si mund ta zbulojmë nëse merremi me thashetheme? Kur tundohesh për të ndarë diçka për një person tjetër bëji vetes më parë tri pyetje. Përgjigjet për këto pyetje kanë mjaft të ngjarë të na tregojnë nëse po merremi me thashetheme apo jo.

Përse po e them këtë gjë? Mos jam i vendosur të kritikoj? Mos vallë jam i vendosur të njollos emrin e tij apo të saj? A është qëllimi im të ndihmoj apo të lëndoj personin për të cilin po flas? Shpeshherë ndodh që nën maskën e ndarjes së një kërkesë për lutje të ketë vërtet thashetheme. Kujdes kur t'i

përgjigjesh kësaj pyetjeje. Shpesh ne justifikohemi për thashethemet kur qëllimi ynë i vërtetë është për të bërë të duket i vogël tjetri që të tregojmë veten si më të mirë. Në qoftë se e zbulon veten që po mundohesh të justifikosh apo arsyetosh ato që je gati të thuash, ka të ngjarë që je duke bërë një thashethem.

A ka mundësi që të ketë edhe një anë tjetër për këtë që po them?

Thashethemet është edhe një fjalë e pavërtetuar. Në qoftë se ajo që ne po themi nuk është e vërtetuar, atëherë jemi duke u marrë me thashetheme. Është thënë se shumicën e telasheve në botë nuk i shkaktojnë ata që thonë gjithë ç'dinë, por pikërisht ata që thonë më shumë.

A do të ndihesha mirë po t'ia thosha këtë gjë Jezuit? Si do të na përgjigjej Ai për këtë gjë që sapo i treguam për ndonjë tjetër? Ka shumë të ngjarë të na përgjigjet me pyetjen: "E ç'lidhje ka kjo me besimin, apo me faktin që do të jesh nxënësi im?"

Përgjigjet për tri pyetjet e mësipërme na tregojnë nëse vërtet po merremi me thashetheme. Në qoftë se edhe pas kësaj nuk je i sigurt, nëse ato që po përgatitesh të thuash janë thashetheme apo jo, mos i thuaj fare. Vërtet, vallë a është aq e nevojshme t'i thuash?

Një aspekt tjetër për t'u shqyrtuar është nëse kjo që po themi në lidhje me atë njeri është diçka që shërben për ta ngritur atë si person. Tek Efesianët 4:29 gjejmë këto fjalë:

"Asnjëfjalë e keqe le të mos dalë nga goja juaj, por ajo që është e mirë për ndërtimin, sipas nevojës, që t'u japë hir atyre që dëgjojnë".

Çarls Spërxhoni (Charles Spurgeon) dikur ka pohuar se thashethemet "nxjerrin një helm të trefishtë; dëmtojnë folësin, dëgjuesin dhe personin për të cilin flitet".

Si përfundim, si mund t'i ndalojmë thashethemet, këtë ves mëkatar që moleps jetën tonë por edhe invadon dhe shkatërron kishat tona? Rrugëzgjdhja është e dyfishtë: mos i shpërndani thashethemet dhe mos i dëgjoni ato.

Mos e inkurajoni thashethemexhiun. Mos u nxito të besosh atë që thuhet. Drejtoje bisedën në diskutimin e anëve të mira të personit për të cilin flitet. Asgjë tjetër nuk i tregon vendin e duhur thashethemexhiut më shpejt se kjo. Tek Filipianët 4:8 shkruhet:

"Së fundi, vëllezër, të gjitha gjërat që janë të vërteta, të gjitha gjërat që janë të ndershme, të gjitha gjërat që janë të drejta, të gjitha gjërat që janë të pastra, të gjitha gjërat që janë të dashura, të gjitha gjërat që janë me famë

të mirë, nëse ka ndonjë virtyt dhe nëse ka ndonjë lëvdim, këto mendoni".

5. Analiza e vetvetes

nga Jim Wilson

Analiza e vetvetes është veprimi apo praktika e meditimit mbi veprimet dhe emocionet tona të së kaluarës. Ky meditim ua drejton vëmendjen tonë këtyre gjërave, ne përqendrohemi në to dhe vlerësojmë veten nën dritën e qiririt tonë meditativ regjektiv. Meqenëse e kaluara jonë, e afërt apo e largët, konsiderohet prej shumë vetave si shkak ose shpjegimi i veprimeve e emocioneve të tanishme, shpesh njerëzit inkurajohen për të bërë analizë të tillë. Edhe kur ajo nuk inkurajohet nga të tjerët, kjo praktikohet rregullisht nga mjaft besimtarë të krishterë.

Analiza e vetvetes nuk është sikur të ecësh nën dritën e diellit në një ditë vere. Por, është njëlloj sikur u zbret shkallëve të një bodrumi me një qiri flakëdridhës në dorë. Ke këtë dritë të vockël në dorë që hedh hije të gjata dhe tregon në gjysmëerrësirë skelete, pëlhura merimangash dhe gjëra të pështira zvarritëse.

Këto skelete janë gjëra që na janë bërë gjatë së kaluarës apo që i kemi bërë vetë dhe për të cilat ndiejmë turp. Ato përfshijnë edhe imagjinatën tonë. Personi që është i dhënë pas analizës së vetvetes është si njeriu që futet thellë e më thellë në këtë bodrum të pajetë, apo sikur shqyrton përsëri po të njëjtat skelete. Qiriu nuk është dritë e mirë dhe kurrë nuk të tregon rrugëdaljen nga kjo e kaluar makabër dhe e tmerrshme. Kjo marramendje kurrë nuk të sjell gëzim. Ajo është shkak për depresion. Është mbase shkak kryesor i depresioneve tek njerëzit me personalitete melankolike që jepen marrëzisht pas kërkesës së përsosmerisë.

Ndërgjegjësimi se ka një Gjykatës

Analiza e vetvetes të thotë gjëra të tilla si: "Ç'tmerr!" "Sa turp!" "Zoti nuk mund të më pranojë kurrë". "Sikur të isha Perëndia, nuk do ta falja veten".

Analiza e vetvetes të çon poshtë e më poshtë dhe nuk të ngre lart. Ajo të akuzon, nuk të mbush mendjen për fajin.

Në sallën e gjyqit ka një ndryshim midis akuzuesit dhe bindësit. Akuzuesi është prokurori dhe bindësi është gjykatësi. Prokurori kërkon të provojë fajin dhe gjykatësi jep vendimin në qoftë se ai provohet. Sapo gjykatësi jep vendimin gjykimi merr fund. Sidoqoftë prokurori do të vazhdojë të thotë se personi është fajtor edhe sikur gjykatësi të thotë se ai është i pafajshëm.

Në Bibël, Satani të akuzon që të të vërë në depresion që të bëhesh i papërdorshëm në punën e Perëndisë. Fryma e Shenjtë të bindë për mëkatet e tua vetëm me qëllim që të të falen kur t'i rrëfesh.

Drita e përsosur

E kundërta e analizës së vetvetes së bashku me rezultatet negative që e shoqërojnë gjendet tek 1 Gjoni 1:5-10. Po citojmë vargjet 5 dhe 7: "Dhe ky është mesazhi që dëgjuam nga Ai dhe po jua shpallim juve: Perëndia është dritë dhe në Të nuk ka kurrfarë errësirë... Po të ecim në dritë, sikurse Ai është në dritë, kemi bashkësi njeri me tjetrin, dhe gjaku i Jezu Krishtit, Birit të Tij, na pastron nga çdo mëkat".

Kjo dritë është burimi i gjithë dritës. Ajo nuk është një qiri dritëdobët që regëtin në errësirë. Nuk ka më hije. Jakobi shprehet kështu tek Jakobi 1:17: "Çdo gjë e mirë që na jepet dhe çdo dhuratë e përsosur vjen prej së larti dhe zbret nga Ati i dritave, pranë të cilit nuk ka ndërrim dhe as hije ndryshimi".

Duke qenë se kjo dritë është e plotë, në qoftë se ecim në të, asgjë nuk mund të fshihet. Mëkati tregohet me forcën bindëse në vend të forcës akuzuese. Mëkati falet menjëherë sepse gjaku i Jezuit vazhdon të pastrojë. Shoqëria është normale sepse jemi në dritë dhe pastrohemi herë pas here. Tregohemi të bindur si rezultat i natyrshëm i bindjes për mëkatin dhe pastrimit të tij.

Ka një shembull të mrekullueshëm të kësaj bindjeje, pastrimi, shoqërie e dëgjese tek Isaia 6:1-8:

"Në vitin e vdekjes së mbretit Uziah, unë pashë Zotin të ulur mbi një fron të ngritur dhe të lartë, dhe cepat e mantelit të Tij mbushnin tempullin. Mbi të ishin serafinët; secili prej tyre kishte gjashtë krahë: me dy mbulonte fytyrën, me dy të tjerë këmbët dhe me dy fluturonte. Njëri i bërtiste tjetrit dhe i thoshte: «I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë është Zoti i ushtrive. Tërë toka është plot me lavdinë e Tij».

Shtalkat e portës u tronditën nga zëri i atij që bërtiste, ndërsa tempulli po mbushej me tym. Atëherë unë thashë: «I mjeri unë! Unë jam i humbur, sepse jam një njeri me buzë të papastra dhe banoj në mes të një populli me buzë të papastra; megjithatë sytë e mi kanë parë Mbretin, Zotin e ushtrive».

Atëherë një nga serafinët fluturoi drejt meje, duke mbajtur në dorë një urë zjarri, që kishte marrë me mashë nga altari. Me të ai preku gojën time dhe tha: «Ja, kjo preku buzët e tua, paudhësia jote hiqet dhe mëkati yt shlyhet».

Pastaj dëgjova zërin e Zotit që thoshte: «Kë të dërgoj dhe kush do të shkojë për ne?» Unë u përgjigja: «Ja ku jam, dërgomë mua!»"

Nuk ishte analiza e vetvetes ajo që e bëri Isaian të vetëdijshëm për mëkatin e tij, por ishte të qenët në praninë e Perëndisë. Ai ishte në dritë. Ai nuk mund të heshte për mëkatin e tij; ai nuk mund të fshihej më. Sapo e rrëfeu mëkatin e tij, ai u fal. Sapo u fal, ishte i gatshëm për t'u bindur.

Ti mund të thuash se kurrë nuk ke marrë falje kaq shpejt. Ndoshta kjo vjen për shkak të akuzuesit në vend të bindës-pastruesit. Akuzuesi do që asnjëri të mos falet.

Të jetosh në dritë

Herën tjetër kur ta shohësh se ke tendenca drejt analizës së vetvetes, mos prano ta bësh këtë. Por në vend të saj dil në dritë. Si? Bëj lutjen që gjendet tek Psalmi 139:23-24: "Më heto, o Perëndi, dhe njihe zemrën time; më provo dhe njihi mendimet e mia. Dhe shiko në se ka tek unë ndonjë rrugë të keqe dhe më udhëhiq nëpër rrugën e përjetshme".

Hidhi sytë lart dhe jo brenda. S'ke nevojë të kërkosh mëkatin. Do ta gjesh atë mjaft më shpejt, më qartë dhe me një rrugëdalje prej tij, në qoftë se i drejtohesh Perëndisë dhe punës së përfunduar të Jezu Krishtit.

Mëkati i falur nuk është njëlloj si mëkati i ndrydhur. Analiza e vetvetes kërkon të risjellë me detaje në kujtesë mëkatet e së kaluarës dhe ka prirje të shqetësohet pastaj për të ardhmen. Pali ka thënë: "...duke harruar ato që kam lënë pas dhe duke u prirur drejt atyre që kam përpara, po rend drejt synimit, drejt çmimit të thirrjes së lartme të Perëndisë në Krishtin Jezus". Jezui tha: "Mos u brengosni, pra, për të nesërmen, sepse e nesërmja do të kujdeset vetë për vete. Secilës ditë i mjafton pikëllimi i vet". Të harrosh të kaluarën nuk do të thotë të ndrydhësh mëkatin në qoftë se është falur e kaluara.

Të ecësh në dritë nënkupton një aktivitet të së tashmes, të mos mbetesh në të kaluarën dhe as të mos shqetësohesh për të ardhmen. Kjo do të thotë ta dëgjosh bindësin, por jo akuzuesin. Do të thotë të marrësh pastrimin dhe të përgjigjesh me bindjen tënde.

Nëse këto fjalë ju kanë shtyrë të mendoni mbi problemet e shpirtit, ju ftojme të na shkruani, dhe do të na vijë mirë t'ju ndihmojmë:

AEM-MISIONI UNGJILLOR

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë
Si të çlirohemi prej hidhërimit / përkth. Alfred Kola, Holger
Dashi ; red. Pandush Ikononi, Dan Baynes. - Tiranë : AEM -
Misioni Ungjillor, 2025.
1 burim në linjë (36 f.)
Tit. origj.: How to be free from bitterness.
ISBN 9789992795996
1.Feja kristiane 2.Jeta e krishterë

